



# Zëri i Grave Kosovare

Mars 2014

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Bashkangjituni!

### Takimi Rregullt i RrGGK

12 Prill, ora 11-15, Hotel Prishtina

## Në këtë numër

Ligji i Ri Njih Personat që Kanë përjetuar Dhunë Seksuale.....2

Fati i Personave të Pagjetur në Kosovë mbetet ende i Pazgjedhur.....2

Gratë Në të Zeza Kujtojnë Krimet në Kosovë.....2

Qeveria e Kosovës Aprovon Planin e Veprimit të Rezolutës 1325..... 3

Zyrtarët e KFOR-it Mësojnë nga Përvojat e Aktivisteve për të Drejtat e Grave, Kontribut në Zbatimin e Rezolutës 1325 UNSCR.....3

RrGGK merr Pjesë në Takimin e Organizuar nga MFSK.....3

Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjës ofron Ligjerata për Edukatë Seksuale.....4

Anëtarët punojnë në Strategjinë e Re të RrGGK.....4

“Gratë Avokojnë në Nivel Lokal” organizuar nga RrGGK.....4

 [Faqja në Facebook](#)

 [Lista e dërgesave të E-Buletinit](#)

punën e Këshillit thelbësore në mbështetjen e të mbijetuarve dhe adresimin e mungesës së llogaridhënies, raporto i radio Evropa e Lirë.

“Është përparim i konsiderueshëm që nga vizita ime e vitit të kaluar, kur ju shpjeguat se vendi juaj vazhdon të përballet me një numër sfidash në trajtimin e çështjes së dhunës seksuale gjatë konfliktit,” ka thënë Hague.

## Presidentja krijon Këshillin për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale

Në një zhvillim tjetër të rëndësishëm, Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga ka themeluar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë luftës me 7 mars, ku RrGGK është anëtare.

"Pesëmbëdhjetë vjet pas luftës, tema e viktimave të dhunës seksuale mbetet një temë tabu për t'u adresuar," tha Presidentja Jahjaga gjatë takimit të parë të Këshillit, ku morën pjesë akterët vendorë dhe ndërkombëtarë. "Të mbijetuarat e dhunës seksuale vazhdojnë të vuajnë nga sëmundje të rënda psikologjike, si dhe nga vështirësitë socio-ekonomike.

Ato kërkojnë mbështetje institucionale dhe shoqërore për t'u përballuar me realitetin e tyre të vështirë."

Këshilli solli së bashku përfaqësues të ministrive kryesore që mund të mbështesin të mbijetuarat e dhunës, shoqërinë civile dhe palët ndërkombëtare drejt një përmirësimi, përgjigje më të mirë të koordinuar. Këshilli është themeluar në përgjigje të shqetësimeve dhe çështjeve të ngritura nga gratë që kishin përjetuar dhunë seksuale. Presidentja Jahjaga u takua me gratë për të dëgjuar shqetësimet e tyre, në diskutime të ndihmuara nga RrGGK.

Përmes Fondit të Grave të Kosovës (përkrahur nga [Kvinna till Kvinna](#) dhe [Austrian Development Agency](#)), RrGGK ka mbështetur gratë të mbijetuarat për të avokuar në institucionet për të adresuar më mirë nevojat e tyre.

Gjatë fillimit të Këshillit, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së foli për rolin që kanë luajtur organizatat e grave në përkrahjen dhe avokimin për të mbijetuarit e dhunës seksuale.

Sekretari i Jashtëm britanik William Hague uroi Presidenten Jahjaga dhe vlerësoi nismën

e saj për themelimin e Këshillit.

Ai e ka konsideruar



Presidentja Atifete Jahjaga krijon Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës.

## Ligji i Ri Njih Personat që Kanë Përjetuar Dhunë Seksuale

Me 20 mars, [Kuvendi i Republikës së Kosovës](#) ka aprovuar ligjin Nr. 04/L-054 për statutin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. Ligji i ri përfshinë të mbijetuarit e dhunës dhe abuzimit seksual që kanë ndodhur gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë, duke njohur gjendjen e tyre, në një përpjekje për të penguar stigmatizimin shoqëror dhe për të mundësuar kthimin e dinjitetit të tyre. Miratimi ka rezultuar si punë dyvjeçare e avokimit intenziv të ndërmarrë nga gratë, shoqëria civile dhe nga organet politike. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dhe organizatat anëtare të saj kanë ndihmuar këtë proces. RrGGK në mënyrë efektive solli gjendjen e vështirë të personave që kanë vuajtur dhunën seksuale gjatë luftës në ballë të diskutimit publik me anë të një proteste të organizuar më 8 mars 2012, me moton: "Nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës," protestë e cila ngriti vëmendjen e publikut dhe institucioneve për këtë çështje.

Që atëherë, RrGGK së bashku me grupet e tjera të shoqërisë civile ka shkruar disa letra dhe është takuar me anëtarët e Kuvendit të Kosovës, ndër të tjera, duke kërkuar miratimin e këtij ligji të rëndësishëm. "Pasi që dhuna seksuale është përdorur si armë lufte, gratë duhet të marrin të njëjtat beneficione si të gjitha viktimat e tjera të luftës," ka shkruar RrGGK në letrën e saj të fundit, të dërguar më 19 Mars. ([Klikoni këtu për të lexuar letrën](#)) RrGGK falenderon anëtarët e kuvendit për punën e tyre dhe përshëndetë miratimin e këtij Ligji, si një hap përpara për të kthyer dinjitetin grave të cilat kanë vuajtur mjaft.

## Fati i Personave të Pagjetur në Kosovë Mbetet ende i Pazgjidhur

Përsëri këtë vit në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me 8 mars, RrGGK doli në rrugë për të mbështetur iniciativën e shoqatës Thirrjet e Nënave. Thirrjet e Nënave dhe RrGGK kanë organizuar një protestë në solidaritet me nënat, gratë, motrat dhe vajzat e personave të pagjetur me moton: "Jemi me ju." Afërsisht 200 njerëz marshuan nga Sheshi Zahir Pajaziti drejt Kuvendit të Kosovës, duke rikujtuar fatin ende të pazgjidhur të personave të pagjetur në Kosovë. Përdersia Kosovare festuan Ditën Ndërkombëtare të Gruas, gratë ngritën zërin dhe iu kujtuan të gjithëve se ato nuk kanë anëtarë të familjes për t'ua uruar atyre këtë festë; pas 15 vitesh, familjarët e tyre ende mbesin të pagjetur. Ato poashtu deshën të rivendosin fotografitë e personave të pagjetur, të cilat janë hequr nga rrethojat e Kuvendit të Kosovës. "Plot 15 vjet po na mashtrojnë e neglizhojnë përderisa kriminelët po sillen të lirë dhe ata pak kriminelë që janë dënuar po ju ulen dënimet," tha Nesrete Kumnova, Udhëheqëse e Thirjet e Nënave: "Mungon drejtësia për mijëra të vrarë, të dhunuar dhe të zhdukur. Do kthejmë fotografitë aty ku ishin se çështja për të pagjeturit nuk është zgjidhë akoma."

Protestuesit rivendosën fotografitë e personave të pagjetur jashtë Kuvendit, duke i kujtuar zyrtarëve detyrat e tyre për të zgjidhur këtë çështje. Mes protestuesve ishte Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës së Prishtinës, së bashku me fëmijët e tij, Dhjetra të rinjë e të reja, si dhe një delegacion i Kaukazit të Jugut u bashkangjitën në protestë.



Më 8 mars, qindra protestojnë në mbështetje të nënave, grave, motrave dhe bijave të personave të zhdukur, të organizuar nga Thirrja e Nënave dhe RrGGK.

## Gratë Në të Zeza Kujtojnë Krimet në Kosovë

Me 26 mars, Gratë në të Zeza nga Serbia, organizuan një performancë në Beograd, duke njohur krimet e kryera nga regjimi serb kundër civilëve shqiptar para 15 viteve.

Gratë në të Zeza rikujtuan dëbimin e mbi 800 mijë shqiptarëve nga shtëpitë e trojet e tyre, keqtrajtimin, vrasjen e civilëve e të zënëve robër, dhunimin e grave, marrjes së dokumenteve, djegies së të gjitha objekteve e plaçkitjeve.

"Ne shprehim ngushëllimet tona më të thella dhe solidaritetin me familjet për humbjet e tyre dhe dhimbje pafund, për poshtërimin që ishte shkaktuar nga regjimi serb në atë kohë," thanë ato.

Gratë në të Zeza kërkuar të zbardhen dhe të publikohen të dhënat për personat e pagjetur shqiptarë; të publikohen të gjitha të dhënat për varret masive në Serbi ku ndodhen mbetjet mortore të personave me kombësi shqiptare; të ndërmerren të gjitha veprimet me qëllim të procedimit të përgjegjësve për krimet e bëra ndaj personave me kombësi shqiptare dhe kryesit e krimeve të marrin dënimet përkatëse.

Stasha Zajoviq ka thënë se deklaratat e deritashme dhe premtimet e pushtetit kanë qenë retorikë boshe. Ajo tha se ka shumë rëndësi në mënyrë që pushteti të tregojë se me të vërtetë mendon seriozisht të ballafaqohet me të kaluarën dhe të shkëputet "nga barra e madhe e politikës së krimet" të regjimit të Sllobodan Millosheviqit.

Aktivistet para monumentit *Krnjaz Mihaili* shpalosën banerin "E mbajmë në mend krimin në Kosovë" në gjuhën shqipe e serbe. Ai poashtu mbante mesazhin: Gratë në të Zeza kundër luftës.

## Qeveria e Kosovës Aprovon Planin e Veprimit të Rezolutës 1325

Më në fund, u shpague dhjetë vitet e avokimit të RrGGK-së për krijimin e një Plani Kombëtar të Veprimit në Kosovë, për implementimin e [Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara](#)

Me 7 Mars, Agjencia për Barazi Gjinore e cila funksionon në kuadrin e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ka lansuar Planin e Veprimit për Zbatimin në Kosovë të Rezolutës 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria", të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Qeveria ka aprovuar zyrtarisht Planin e Veprimit me 29 janar.

Zbatimi i Rezolutës 1325 kërkon ngritje të nivelit të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, procese paqësore, fuqizim të mekanizmave mbrojtës dhe inkooporim të dispozitave të barazisë gjinore në të gjitha sistemet demokratike.

Edona Hajrullahu, Drejtore Ekzekutive e [Agjencisë për Barazi Gjinore](#), theksoi se plani i veprimit është tejet i rëndësishëm pasi që do të adresojë problemet e sigurisë në Kosovë, do të mundësojë harmonizimin e strategjive që kanë në qendër barazinë gjinore, fuqizimin e gruas dhe sigurinë e saj, do mundësojë dhe lehtësojë bashkëveprimin e akterëve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

## Zyrtarët e KFOR-it Mësojnë nga Përvojat e Aktivisteve për të Drejtat e Grave, Kontribut në zbatimin e Rezolutës 1325 UNCSR

Më 14 mars, Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë (KFOR), Gjeneral-Major-Salvatore FARINA, mirëpriti aktivistet e të drejtave të grave për të folur me zyrtarët e lartë për pozitën e grave në Kosovë.

Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK-së, informoi zyrtarët e KFOR-it, duke dhënë një kronologji të përfshirjes së grave në proceset e paqes që nga viti 1994. Përfshirë aktivistet e Kosovës në takimet Ish-Jugosllave të Grave në të Zeza, të cilat e nxitën marrëdhënien pozitive në mes të gjithë grupeve etnike, duke lehtësuar procesin e ndërtimit të paqes pas konfliktit. "Kjo përvojë na mësoi të urrejmë regjimin Serb, por jo njerëzit Serb," tha Rogova. Ajo gjithashtu theksoi se paratë nuk mund të blejnë pajtimin dhe se bashkëpunimi në mes të grupeve etnike duhet të vijë në kohën tonë dhe mënyrën tonë."

Për të argumentuar këtë, ajo ndau storie nga përpjekjet e RrGGK-së për të rindërtuar marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve që nga viti 2000. Rogova gjithashtu theksoi rëndësinë e përfshirjes së burrave në avancimin e barazisë gjinore në situatat pas konfliktit.

Afërdita Sylaj nga [Community Building Mitrovica \(CBM\)](#) foli gjithashtu për rolin që organizata e saj ka pasur në ndërtimin e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës.

Pas këtij diskutimi të nivelit të lartë, u organizua një takim mes Rogovës, Këshilltares të KFOR-it për çështje Gjinore Lotta Ekvall dhe Komandantit të KFOR-it, Gjeneral-Major-Salvatore Farina në Film City, Prishtinë, me 14 mars. Gjatë takimit, ata diskutuan çështje politike, zgjedhjet lokale dhe statusin e grave në Kosovë.

RrGGK mirëpret dhe falenderon KFOR-in për përpjekjet e fundit për të zbatuar Rezolutën 1325 duke u konsultuar me aktivistet për të drjetat e grave për nevojat specifike në kontekstin e pas luftës në Kosovë.

## RrGGK merr pjesë në Takimin e Organizuar nga MFSK

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të grave, 8 Marsit, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, organizuan në ambientet e Kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), një takim me të gjitha gratë që shërbejnë në Ministri dhe FSK, ushtarake dhe shërbyese civile.

Në këtë takim morën pjesë, ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjeneral lejtant Kadri Kastrati, Komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Farina, zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, Drejtoresha Egzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova, si edhe deputetja Ganimete Musliu, anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së.

Femrat që punojnë në Ministri dhe Forcë janë shumë aktive, të devotshme dhe vazhdimisht kanë dhënë rezultate në punë dhe shërbim," tha Ministri Çeku.

Komandanti i FSK gjeneral-lejtant Kadri Kastrati mbështeti fuqishëm angazhimin e grave, duke deklaruar: "Ndihem krenar që jam Komandanti i Forcës që me sukses i shërben meshkujt dhe femrat pa dallim."

Gjeneral major Salvatore Farina, komandanti i KFOR-it në Kosovë, foli për rolin e femrave në Forcat e Armatosura si dhe u shpreh se ndjehet i entuziazmuar me zhvillimet që i ka bërë FSK-ja duke arritur të rekrutoj dhe trajtoj me dinjitet një numër të mirë të femrave, duke e ditur që edhe në vendet e NATO-s, rekrutimi ka filluar jo shumë vite me parë, duke përmendur shembullin e Italisë, e cila ka filluar angazhimin e femrave në ushtri që nga viti 2000. Ai me këtë rast përgëzoi ministrin Çeku dhe gjeneral Kastratin për kujdesin e treguar ndaj çështjes gjinore.

Rogova prezantoi një histori të përfshirjes së grave në lidhje me Ditën Ndërkombëtare të Gruas në Kosovë.

## Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes ofron Ligjerata për Edukatë Seksuale

Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes (SHEPF) organizoi ligjerata për sëmundjet seksuale të transmetueshme dhe abuzimit të drogës për nxënësit e shkollave fillore në Gjakovë. Në mungesë të kurrikulave zyrtare në shkollat e Kosovës për këto çështje, punëtoritë ofruan informata të rëndësishme.

Në përpjekje për të bërë të mësuarit argëtim, SHEPF organizoi më 15 mars një kuiz në shkollën fillore Fehmi Agani me nxënës nga shkollat fillore Mazllom Këpuska dhe Fehmi Agani. Ata garuan me entuziazëm, duke iu përgjigjur pyetjeve lidhur me HIV / AIDS dhe drogën. Të dyja palët konkurruese iu përgjigjën të gjitha pyetjeve me sukses dhe saktësisht. Prandaj, në fund të gjithë dolën fitues. Pas kuizit, nxënësit dhe mësuesit ndanë edhe më shumë informata. "Është e dhimbshme kur ne kemi mundësinë për të mbrojtur veten nga këto sëmundje, por nuk e bëjmë këtë, sepse ne nuk kemi informata për këto sëmundje," tha nxënësja Meri Komoni. "Së fundmi, një jetë mund të humbet për shkak të kësaj." Me 21 mars, SHEPF organizoi një tryezë të rrumbullakët me zyrtarë nga Departamenti komunal i Arsimit, drejtor të shkollave dhe përfaqësues të Qendrës së Mjekësisë Familjare. SHEPF hartoi një strategji ku rekomandon përfshirjen e edukimit seksual si lëndë në kurrikulën shkollore në Gjakovë



Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes (SHEPF) ofroi edukim për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe abuzimin me drogë për nxënësit e shkollave fillore në Gjakovë.

"Synimi ynë i ardhshëm do të jenë nënat," tha Bahrije Deva Vehapi e cila drejton iniciativën. "Ne do t'i angazhojmë nënat dhe fëmijët që t'i tejkalojnë barrierat e komunikimit, në mënyrë që ata të ndjehen të lirë për të folur për këto çështje."

Duke marrë parasysh që vajzat të cilat morën pjesë në Iniciativën e RrGGK për Fuqizimin e Vajzave kanë identifikuar komunikimin në mes të prindërve dhe të rinjve si sfidë kyçe, iniciativa e SHEPF-së po ndihmon për të adresuar shqetësimet e rinisë. SHEPF ka marrë përkrahje nga Fondi i Grave të Kosovës, i mbështetur nga [Kvinna till Kvinna \(Ktk\)](#) dhe [Austrian Development Agency \(ADA\)](#).

## Anëtarët Punojnë në Strategjinë e Re të RrGGK

Anëtarët e RrGGK u mblodhën me 10 mars, në Hotel Prishtina, që të punojnë në draftimin e strategjisë së re të RrGGK për vitet 2015-2018. Ato u ndanë në grupe për të rishikuar programet në strategjinë ekzistuese të RrGGK. Secili grup diskutoi mbi objektivat që janë ende të rëndësishme të vazhdojnë dhe objektiva të tjera që duhet të shtohen si pjesë e aktiviteteve të mëtutjeshme të RrGGK.

Ky ishte takimi i parë me anëtarët për draftimin e strategjisë së re, për të vazhduar edhe në takimin tjetër që do të mbahet gjatë muajit qershor.

## "Gratë Avokojnë në Nivel Lokal" organizuar nga RRGK

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) organizoi punëtorinë dy ditore në Durrës, me 28-30 mars, me qëllim të bashkëpunimit më të mirë në mes grave në Asambletë komunale dhe organizatave që janë anëtare të RRGK.

Në kuadër të Strategjisë së Veprimit të RrGGK, njëra ndër objektivat më të rëndësishme është: Gratë të marrin pjesë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror.

RrGGK e sheh të mundur këtë pjesëmarrje aktive duke bashkëpunuar dhe avokuar së bashku me organizatat e grave për çështjet që preokupojnë gratë në nivel lokal dhe qendror.

Gjatë punëtorisë në Durrës, gratë në politikë dhe organizatat e grave, planifikuan së bashku për çështjet që duhet avokuar drejt përmirësimit të pozitës së grave në nivel lokal. RrGGK ka ftuar për këtë punëtori 50 gra nga këto komuna: Prizreni, Gjlani, Novobërda, Obiliçi, Dragashi, Ferizaji, Vitia, Drenasi, Lipjani dhe Vushtrria.



(RRGGK) organizoi punëtorinë dy ditore në Durrës 28-30 Mars, me qëllim të bashkëpunimit më të mirë në mes grave në Asambletë komunale dhe organizatave që janë anëtare të RRGK.